



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2021:135172

Datë: 05.06.2024

Numri i dokumentit: 05786322

C.nr.617/21

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË, me gjyqtarin Selajdin Gallapeni, si dhe pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Labinot Demiraj, në çështjen juridike civile të paditësve E.P, N.SH, L.S, A.B, V.B dhe A.H, që të gjithë të punësuar në SH.F.M.U “17 shkurti”, në S, të cilët i përfaqëson e autorizuara I. Xh – K, avokate nga S, ndaj të paditurës K e S, D. K e A, të cilën e përfaqëson i autorizuari A. B, përfaqësues ligjor i K së S, për shkak të kompensimit diferencës në emër të licencimit / gradimit, gjykata me qëllim të ekonomizimit të procedurës, jashtë shqyrtimit, më 05.06.2024, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M
- Pa shqyrtim kryesor -

- I.** APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësve E. P, N. Sh, L. S dhe A. B, ashtu që DETYROHET e paditura K e S, D e A në S, që paditësve në emër të kompensimit të diferencës së papaguar për licencim – gradim, t’ua paguaj shumat si në vijim:
- Paditëses E. P, për periudhën 28.06.2018 e deri më datë 31.01.2023, gjegjësisht për (55 muaj), t’ia paguaj shumën prej 3,044.25 euro;
 - Paditëses N. Sh, për periudhën 28.06.2018 e deri më datë 31.01.2023, gjegjësisht për (55 muaj), t’ia paguaj shumën prej 3,044.25 euro;
 - Paditëses L. S, për periudhën 28.06.2018 e deri më datë 31.01.2023, gjegjësisht për (55 muaj), t’ia paguaj shumën prej 3,044.25 euro;
 - Paditësit A. B, për periudhën 28.06.2018 e deri më datë 31.01.2023, gjegjësisht për (55 muaj), t’ia paguaj shumën prej 2,141.55 euro;
- II.** APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësve V. B dhe A. H, ashtu që DETYROHET e paditura K e S, D e A në S, që paditësve në emër të

kompensimit të diferencës së papaguar për licencim – gradim, t’ua paguaj shumat si në vijim

- Padi tëses V. B, për periudhën 28.06.2018 e deri më datë 31.01.2023, gjegjësisht për (55 muaj), t’ia paguaj shumën prej 1,191.85 euro;
- Padi tëses A. H, për periudhën 01.10.2018 e deri më datë 31.01.2023, gjegjësisht për (52 muaj), t’ia paguaj shumën prej 4,629.56 euro

Të gjitha këto shuma si në pikën I (një) dhe II (dy) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me kamatë ligjore prej 8%, prej ditës së parashtrimit të padisë (28.06.2021), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të detyrueshëm.

III. REFUZHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë përtej shumes së aprovuar si në pikën II (dy) të dispozitivit të këtij aktgjykimi si e pabazuar.

IV. DETYROHET e paditura K e S – D e A, që padi tësve t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës në vlerë prej 645.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të detyrueshëm, ndërsa pjesa tjetër në lidhje me shpenzimet e procedurës përtej shumes se aprovuar REFUZHET.

A r s y e t i m

Paditësit përmes të autorizuarës të tyre Av. I. Xh - K nga S, kanë parashtruar padi më datë 28.06.2021, pranë kësaj gjykatë kundër të paditurës K e S – D e A, me të cilën kanë kërkuar kompensimin nga marrëdhënia e punës në emër të gradimit – licencimit për faktin se të njëjtit shërbejnë si mësimdhënës tek e paditura, bazën e padisë e kanë mbështetur në Kontratën Kolektive të nënshkruar nga SBASHK-u dhe Ministria e Arsimit, gjegjësisht në nenin 7 par.1 të kësaj kontrate. Andaj ka theksuar se meqenëse mësimdhënësit fillimisht i janë drejtuar DKA-së për përmbushje të kërkesave në procedurë administrative me anë të së cilës kanë kërkuar kompensimin për licencim sipas afateve të përcaktuara me ligj.

E paditura K e S – DKA, përmes të autorizuarit të saj theksuar se sa i përket kërkesës për kompensim e kualifikimit arsimor – avancimit në karrierë e kundërshtojmë në tërësi si të pabazuar për shkak se në rastin konkret paditësi ka nënshkruar një kontratë të punës ku janë paraparë të drejtat dhe detyrimet e në mesin e tyre edhe paga, duke llogaritur edhe gradimin në shumën e caktuar si në kontratën bazë. Po ashtu ka theksuar se paditësit nuk kanë licencë valide dhe

gjithashtu është thirrur në institutin e parashkrimit , përkatësisht në nenin 87 të Ligjit të punës, prandaj në fund ka theksuar se i propozojmë gjykatës që kërkesëpadinë e gjykatës të e refuzoj si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitura nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 ndërlidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është **pjesërisht e themeltë**, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në mes të palëve ndërgjygjëse nuk është kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie punë tek e paditura.

Kontestues ishte fakti nëse paditësit janë kompensuar në shumën që ju takon në bazë të nivelimit të shkollimit si dhe a ju takon të ju njihet diferenca e papaguar.

Bazuar ne faktet jo kontestuese siç janë kontrata e punës për paditësit, është vërtetuar pa mëdyshje se të njëjtit janë paguar në emër të gradimit për çdo muaj veç e veç, mirëpo jo në shumën që ju takon në bazë të nivelit të shkollimit, gjegjësit me 19% për të punësuarit në arsim me shkollë të lartë pedagogjike, 27% për të punësuarit në arsim me nivel të shkollimit bachelor si dhe me 35%, për të punësuarit me nivel të shkollimit master.

Deri te shumat aprovuese, gjykata ka ardhur sipas kësaj formule (paga baze e paditësit x niveli i shkollimit, minus të ardhurat që i kanë siguruar në emër të gradimit, ku nga kjo shumë e mbetur i është shumëzuar me muajt që i takon të i njihet diferenca e papaguar, duke arritur kështu në shumën përfundimtare, për të cilat ka vendosur gjykata për secilin paditës veç e veç, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi).

Në bazë të Vendimit Nr.01/33, datë 29.08.2008, gjykata gjeti së Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 29 gusht 2008, ka marrë vendim, ku sipas pikës 3 të këtij vendimi përcaktohet se “ngritja e pagave për mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në nivelin fillorë dhe atë të mesëm bëhet në bazë të kriterëve të licencimit, si: përgatitja profesionale (kualifikimi) dhe përvoja e punës”.

Ndërsa në pikën 4 theksohet se, citojmë: *Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët), dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur:*

- 1) *Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10 %;*
- 2) *Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19 %;*

- 3) *Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27 %;*
- 4) *Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë), përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35 %.*

Në bazë të provave të administruara, gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar.

Sipas nenit 7 par. 1, pika 1.1, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë 01B-Nr.prot.2056, e cila ka hyrë në fuqi nga data 18.04.2017, është paraparë së "Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit.

Lidhur me vendosjen si në pikën dy të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi që paditëses V. B, t'ia njeh diferencën e papaguar në shumën prej 1,191.85, për faktin se përkundër që e autorizuar e saj ka kërkuar që të njëjtës t'i llogaritet gradimi me nivel shkollimi 27%, me të cilën shumë, gradimi iu llogaritet të punësuarve në sistemin e arsimit me nivel shkollimi bachelor, gjykata ka gjetur se e njëjta ka të përfunduar shkollën e lartë pedagogjike dhe në bazë të gradimit i takon të i njihet diferenca duke ia llogaritur sipas nivelit të shkollimit me SHLP – Shkollë të Lartë Pedagogjike.

Ndërsa pjesën tjetër gjykata e ka refuzuar si në pikën e tretë të dispozitivit të këtij aktgjykimi për arsyet e lartcekura, pra të njëjtës i takon pjesa aprovuese me shkolle të lartë pedagogjike ndërsa llogaritja që i është bërë me nivel shkollimi bachelor gjykata e ka refuzuar si në pikën e tretë të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Faktin se paditësja është me SHLP, gjykata e ka vërtetuar nga diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, (Shkolla e Lartë Pedagogjike – Prizren) me nr. 1034 e lëshuar me datë 08.04.2011, me të cilën ka fituar titullin, Arsimitar i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe.

Ndërsa sa i përket paditëses A. H, gjykata vendosi si në pikën e dytë të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata erdhi duke ia llogarit pagën bazë shumëzuar me nivelin e shkollimit master, ndërsa i është minusuar vlera të cilën e ka përfituar për çdo muaj, ndërsa shuma e mbetur i është llogaritur me 52 muaj, duke arritur kështu në shumën përfundimtare.

Sa i përket pretendimeve të palës së paditur në përgjigje në padi se kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesave, gjykata konstaton se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim për faktin se padia është paraqitur me datë 28.06.2021, ndërsa kërkesat janë nga data 28.06.2021, që i bie se kërkesat janë brenda afatit tre

vjeçar dhe nuk kemi të bëjmë me parashkrim konform nenit 87 të Ligjit të Punës, i cili përcakton se, citojmë, “*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.*”

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në nenit 382 të LMD-së, sipas të cilës dispozitë është paraparë së *Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*, dhe si datë nga e cila rrjedh detyrimi i të paditurës për pagesën e kamatës gjykata ka caktuar datën paraqitjes së padisë.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve për përpilimin e padisë, në shumë prej 624.00 euro, për taksë gjyqësore për padi, shumë prej 21.00 euro, (sipas tarifës së Odës së Avokatëve), në shumë të përgjithshme prej 645.00 euro sipas Tarifës së Odes së Avokateve, ndërsa në lidhje me shpenzimet për precizimin e kërkesëpadisë, gjykata e ka refuzuar shumë prej 624.00 euro për faktin se precizimi i padisë nga paditësit është bërë par kërkesën e gjykatës si dhe padia që nga fillimi ka qenë me të meta dhe palët paditëse kanë qenë te obliguara që t'i evitojnë të metat nga padia.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat e në kuptim të nenit 152 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:135172, 05.06.2024**

G j y q t a r i

Selajdin Gallapeni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.